



Kingdom of the Netherlands



## **DOKUMENT POLITIKASH**

# **Rruga e Shqipërisë drejt Integritimit Europian:**

## **Kontrolli financiar dhe procesi i hapjes së negociatave për Kapitullin 32**

**Qershor, 2022**

Dokumenti është hartuar nga AIS, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shqipëri, në kuadër të projektit C1-EU-NPA.



Dokumenti i Politikave me titull “Rruga e Shqipërisë drejt Integritimit European: Kontrolli financiar dhe procesi i hapjes së negociatave për Kapitullin 32” është hartuar nga organizata Albanian Institute of Science AIS/Open Data Albania, në zbatim të projektit C1 – EU – NPA “Përmirësimi i Debatit mbi Politikat dhe Llogaridhënien për të Përbushur të Drejtat Bazike”, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster 1 Shqipëri.

Projekti zbatohet nga katër organizata shqiptare: Center for the Study of Democracy and Governance CSDG, Instituti i Studimeve Politike ISP, Komiteti Shqiptar i Helsinkit KSHH dhe Albanian Institute of Science AIS, me mbështetje të Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës në Tiranë.

Dokumenti i Politikave “**Rruga e Shqipërisë drejt Integritimit European: Kontrolli financiar dhe procesi i hapjes së negociatave për Kapitullin 32**” prezantohet si pjesë e iniciativave të shoqërisë civile, që synojnë të japin kontributin e tyre në integrimin europian të vendit.

Gjetjet, Opinionet apo Rekomandimet e shprehura në këtë event përfaqësojnë këndvështrime të ekspertëve dhe organizatës AIS dhe nuk përkojnë me përgjegjësi të partnerëve apo mbështetësve të Projektit C1-EU-NPA.



## Hyrje

### *“Financat pa strategji janë thjesht numra, strategjia pa kontroll financiar është iluzion”*

- **Qëllimi:** Ky dokument ka si qëllim të mbështesë procesin e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), nëpërmjet përmirësimit të debatit publik dhe transparencës lidhur me Kapitullin 32 “Kontrolli Financiar”, në funksion të forcimit të rolit të përgjithshëm dhe vizibilitetit të shoqërisë civile shqiptare në procesin e negociatave me BE-në.
- **Objektivat:** Dokumenti synon të informojë në lidhje me procedurat e anëtarësimit në BE, detyrimet që ka Shqipëria në lidhje me negocimin e Kapitullit 32, ecurinë e përgatitjeve dhe progresin e bërë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA), si dhe adresimin e disa rekomandimeve për fazën e negociatave deri në anëtarësimin e Shqipërisë në BE.
- **Parashtrimi i situatës:** Shqipëria vazhdon punën për zbatimin e MSA-së. Në datë 25 Mars 2020, Këshilli i Evropës vendosi për hapjen e negociatave me Shqipërinë, vendim i cili u pranua nga anëtarët e Këshillit, por me kushtin që Komisioni Evropian të raportojë, mbi një sërë çështjesh që Shqipëria duhet të adresojë, përpara Konferencës së parë ndërqeveritare për hapjen e negociatave.<sup>1</sup> Në Dhjetor 2018, Qeveria ka filluar shqyrtimin analitik të legjislacionit për Kapitullin 32 (screening) në përputhje me acquis të BE-së, proces i cili nuk ka përfunduar. Për shkak të rëndësisë, Kapitulli 32 është përfshirë në klasterin e parë negociues “Të drejtat themelore, të parat”, i cili hapet i pari dhe mbyllet i fundit në procesin e negocimit me Komisionin Evropian (KE)<sup>2</sup>. Mjaftueshëm progres duhet të arrihet në klasterin e parë, rrjedhimisht edhe për Kapitullin 32, përpara se të hapen klasterat e tjerë për negocim<sup>3</sup>. Kontrolli financiar ka si objektiv të përmirësojë disiplinën financiare të administratës publike, të sigurojë transparencë në përdorimin e fondeve publike, dhe të mbrojë interesat financiare të BE. Përbushja e detyrimeve përbën prioritet për Qeverinë Shqiptare (Qeveria), jo vetëm si një kusht për anëtarësim në BE, por si një detyrim i brendshëm i mirëqeverisjes së vendit, në funksion të arritjes së stabilitetit financiar, parandalimit të keqpërdorimit të mjeteve financiare, dhe shpenzimit me eficiencë dhe transparencë të fondeve publike<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Raporti i Shqipërisë 2021. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)

<sup>2</sup> Klasteri i parë përfshin: Kapitulli 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore; Kapitulli 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria – Kriteret Ekonomike – Funkcionimi i Institucioneve Demokratike – Reforma e Administratës Publike; Kapitulli 5 – Prokurimet Publike; Kapitulli 18 – Statistikat; dhe Kapitulli 32 – Kontrolli Financiar.

<sup>3</sup> KE (2018), A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, p. 4, [https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf)

<sup>4</sup> PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN (PKIE 2021–2023), VKM Nr. 90, datë 17.2.2021, <http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6170&token=5fde9f7a2fd7e514f53b853364e79ca24f397160PKIE 21-23>

- **Opinionii i BE-së:** Progres Raporti<sup>5</sup> i KE-së (Raporti) vlerëson se Shqipëria është “përgatitur në mënyrë të moderuar” dhe ka bërë “**progres të pjesshëm**” në fushën e Kontrollit Financiar. Opinionii mbi përgatitjen dhe progresin e bërë për Kapitullin 32 është i njëjtë dhe i pandryshuar nga viti 2015. Progres është bërë gjatë 2020, veçanërisht lidhur me miratimin e politikës për forcimin e mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP), të instruksioneve mbi delegimin e përgjegjshmërisë financiare, të udhëzimit për monitorimin dhe raportimin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm, si dhe me rishikimin e procedurave të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) mbi kontrollin e cilësisë dhe dhënien e sigurisë të auditimit të jashtëm. Megjithatë, Komisioni vlerëson se funksionimi i duhur dhe efektiv i kornizës së kontrollit të brendshëm të financave publike ende nuk është siguruar në të gjitha njësitë buxhetore<sup>6</sup>. Rekomandimet e KE-së, të mbartura nga viti i kaluar, lidhen me zbatimin e parimit të **delegimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies menaxheriale**, me monitorimin dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit të **kontrollit të brendshëm të financave publike**, dhe me forcimin e rolit të **kontrollit parlamentar mbi njësitë e audituara** në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm, përmes seancave më të shpeshta dëgjimore parlamentare dhe krijimit të një kuadri parlamentar monitorimi për të vlerësuar rregullisht masat vijuese të Qeverisë.

### Çështjet kryesore për tu adresuar lidhur me Kapitullin 32

- *“Vendosja e tonit të duhur në krye...”*

Çështjet prioritare të adresuara nga KE, të mbartura ndër vite në Raportet për Shqipërinë, konvergojnë në **kërkesën emergjente të forcimit të kontrollit parlamentar**, për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në të gjitha strukturat buxhetore në nivel qendror dhe lokal, veçanërisht për pranimin dhe adresimin për zbatim të rekomandimeve të KLSH-së. Vlerësohet nevoja e krijimit të një nënkomisioni të ri parlamentar për të adresuar më mirë çështjet e buxhetit, menaxhimit të financave publike dhe kontrollit financiar.

- *“Të drejtat themelore, të parat...”*

Ministria e Financave, institucioni lider për Kapitullin 32, duhet të vlerësojë dhe të adresojë arsyet pse opinionii i KE-së ka mbetur i pandryshuar që prej vitit 2015: “*Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar dhe ka bërë **progres të pjesshëm** në fushën e Kontrollit Financiar*”<sup>7</sup>. Procesi i shqyrtimit analitik të legjislacionit duhet të përfundojë sa më shpejt, për të lehtësuar fazën e negociimit për Kapitullin 32. Klasteri i të drejtave themelore, ku bën pjesë Kontrolli Financiar, përbën një kriter kushtëzues për hapjen e negociatave për kapitujt e tjerë. Përgatitja dhe progresi i bërë në këtë kapitull duhet të jenë prioritet për Qeverinë, për të përshpejtuar hapjen e negociatave për kapitujt e tjerë.

<sup>5</sup> Progres Raporti i Shqipërisë 2021, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)

<sup>6</sup> Idem.

<sup>7</sup> Vlerësim 3, në një shkallë nga 1 në 5.



- “Fokusi tek rezultatet e reformave, përtej përafrimit të legjislacionit...”

Kuadri ligjor, që rregullon çështjet e Kontrollit Financiar, vlerësohet të jetë përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, zbatimi dhe cilësia e sistemeve të kontrollit kanë nevojë për përmirësim të vazhdueshëm. Progresi i bërë për Kapitullin 32 nuk duhet trajtuar vetëm në formë (miratimi i akteve ligjore), por kryesisht në përmbajtje (zbatimi). Sistemi i kontrollit të brendshëm duhet trajtuar si një **reformë gjithëpërfshirëse** e KBFP, në harmoni të plotë dhe në mbështetje reciproke me reformat e administratës publike (PAR) dhe menaxhimit të financave publike (MFP). Nëse një prej reformave nuk është e plotë, zbatimi i secilës prej tyre mbetet i pjesshëm.

- “Transparenca si një faktor suksesi drejt promovimit të vlerave evropiane...”

**Transparenca, përgjegjshmëria dhe llogaridhënia menaxherjale** e institucioneve publike shtrihet në disa nivele kontrolli, duke filluar nga kontrolli i brendshëm brenda kornizës së menaxhimit financiar publik, auditimi i jashtëm, kontrolli parlamentar dhe së fundmi publiku i gjerë. **Roli i shoqërisë civile** në forcimin e mekanizmit të kontrollit financiar publik është thelbësor, pasi mund dhe duhet të kryejë monitorim të vazhdueshëm të proceseve të rëndësishme që kanë ndikim në jetën ekonomike, sociale dhe politike të Shqipërisë.

## **1. Historiku i Marrëdhënieve Shqipëri - BE / Etapat dhe detyrimet e MSA-së**

Shteti Shqiptar është zyrtarisht pjesë e procesit të Stabilizim-Asociimit që prej vitit 2000, por marrëdhëniet me BE-në janë forcuar pas vitit 2006, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA). Neni 70 i MSA-së përcakton detyrimin për angazhimin e Shqipërisë në përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis* e BE-së, proces ky që duhej të përfundonte në dy faza 5-vjeçare, brenda vitit 2019<sup>8</sup>, por që rezultoi të jetë ende në proces. Në vitin 2009, pas hyrjes në fuqi të MSA-së, Shqipëria paraqiti kërkesën për anëtarësim në BE, e cila u miratua nga KE në Qershor 2014, duke i hapur rrugën zyrtarisht përmbushjes së objektivit strategjik të Integritimit Evropian, sipas fazave në vijim<sup>9</sup>:

- Shqyrtimi analitik i legjislacionit respektiv (*screening*), proces që ka filluar në 2018;
- Hapja zyrtarisht dhe zhvillimi i negociatave për 35 kapitujt, proces që pritet të fillojë;
- Përmbyllja e negociatave për çdo kapitull dhe nënshkrimi i Traktatit të Aderimit.

Në bazë të programit qeverisës për periudhën 2021 – 2025, prioriteti i politikës së jashtme të Shqipërisë është avancimi më shpejt drejt anëtarësimit të plotë të Shqipërisë në BE. Arritja e një vendimi pozitiv për nisjen faktike të negociatave për Shqipërinë, nëpërmjet mbajtjes së

8 Ministria e Punëve të Jashtme, Marrëveshjet Shqipëri-BE, <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/dokumente/marreveshjet-shqiperi-be/>

<sup>9</sup> Ministria e Punëve të Jashtme, Kapitujt e Acquis Communautaire, <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/negociatat/>



Konferencës së parë Ndërqeveritare, pas marrjes së vendimit politik të marsit 2020 për hapjen e negociatave, përbën një prioritet për vitin 2022.<sup>10</sup>

Si vend kandidat për anëtarësim në BE<sup>11</sup>, Shqipëria ka detyrimin të përmbushë plotësisht “**Kriteret e Kopenhagenit**”<sup>12</sup>, fazë e cila synon të vlerësojë progresin e bërë dhe përgatitjen e shtetit shqiptar në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit:

- Përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis* të BE-së;
- Ngritjen e institucioneve dhe rritjen e kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislacionit;
- Vërtetimin, përmes treguesve të performancës, për zbatimin e legjislacionit të përafruar me *acquis* të BE-së.

Pra, përmbyllja me sukses e negociatave synon të vlerësojë jo vetëm përafrimin e legjislacionit nga ana formale, por gjithashtu **të krijojë evidenca të mjaftueshme që Shqipëria ka kapacitetet e nevojshme ligjore dhe institucionale për të zbatuar *acquis* dhe reformat e tjera ekonomike, politike dhe sociale të BE-së**. Vetëm pas mbylljes së negociatave për të gjithë kapitujt negociues, Shqipëria do të jetë gati për anëtarësim në BE.

## 2. Struktura e Kapitullit 32 “Kontrolli Financiar”

Për qëllime të negociimit, *acquis* i BE-së ndahet në 35 kapituj negociues, të grupuar në 6 klastera. Për shkak të rëndësisë, Kapitulli 32 është përfshirë në klasterin e parë negociues “Të drejtat themelore, të parat”<sup>13</sup>, i cili hapet i pari dhe mbyllet i fundit në procesin e negociimit. Kapitulli 32 mbulon çështje që përbëjnë shtyllat kryesore të ndërtimit të një sistemi financiar publik të shëndetshëm, themelet e të cilit janë transparenca, përgjegjshmëria dhe llogaridhënia menaxheriale për financat publike. Objektivat kryesore të Kapitullit 32 synojnë vendosjen e stabilitetit financiar të shteteve anëtare, parandalimin e keqpërdorimit të mjeteve financiare, si dhe realizimin e shpenzimeve më efikase, të suksesshme dhe të përgjegjshme, si një mekanizëm i rëndësishëm për të luftuar korrupsionin.

*“BE promovon reformën e sistemeve të qeverisjes kombëtare për të përmirësuar llogaridhënien menaxheriale, menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe auditimin e jashtëm të fondeve publike. Rregullat e kontrollit financiar mbrojnë më tej interesat financiare të BE-së kundër mashtrimit lidhur me menaxhimin e fondeve të BE-së dhe kundër falsifikimit të euros.”*

Kapitulli 32 mbulon katër çështje kryesore, të cilat do të shqyrtohen në seksionet në vijim:

<sup>10</sup> Ministria e Punëve të Jashtme, PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2022 – 2024, fq 8, [http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN\\_Final.pdf](http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf)

<sup>11</sup> Këshilli i Bashkimit Europian, Përfundimet e KE të datës 24.06.2014 për Shqipërinë, <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8288-2014-INIT/en/pdf>

<sup>12</sup> Shtetet anëtare duhet të sigurojnë: institucione për të garantuar demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve (**Kriteri Politik**); ekonomi tregu funksionale e të aftë për të përballuar konkurrencën në tregun e BE-së (**Kriteri Ekonomik**); dhe kapacitete administrative dhe institucionale të afta për të zbatuar *acquis* të BE-së.

<sup>13</sup> Komsioni Evropian (2018), A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, p. 4, [https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf)



- Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik (KBFP),
- Auditimi i Jashtëm (AJ),
- Mbrojtja e Interesave Financiare të BE-së, dhe
- Mbrojtja e *Euros* nga falsifikimi.

KE monitoron rregullisht Shqipërinë për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit dhe publikon çdo vit një opinion mbi progresin, ku evidentohen masat e ndërmarra, problematikat e evidentuara, prioritet për qeverinë dhe një vlerësim i përgjithshëm për progresin e bërë gjatë vitit. Raporti i fundit i KE-së është publikuar në Tetor 2021, ku Shqipëria vlerësohet se **është përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e Kontrollit Financiar**<sup>14</sup>.

Qeveria gjithashtu vetvlerëson se kuadri strategjik për Kontrollin Financiar është **pjesërisht funksional**. Monitorimi i zbatimit të planit për Kapitullin 32 realizohet nga NjQH pranë MFE. Arritjet kryesore janë paraqitur në **Aneksin 1**. Nga ana formale, përafrimi i legjislacionit me *acquis* e BE-së, ngjan lehtësisht i zbatueshëm, por vështirësia qëndron përtej përafrimit, tek **zbatimi në praktikë i sistemeve të kontrollit të brendshëm, të cilat ndërthuren në mënyrë të pazgjidhshme me progresin e bërë në reformën e administratës publike, si dhe në menaxhimin dhe kontrollin e financave publike**.

### **3. Kuadri ligjor dhe institucional ekzistues në Shqipëri për Kontrollin Financiar**

Shqyrtimi analitik i legjislacionit për Kapitullin 32 ka filluar zyrtarisht në **datë 5 dhjetor 2018**. *Acquis* i BE-së nuk përcakton dispozita ligjore specifike për t'u përafruar në fushën e kontrollit financiar, por kërkon nga shtetet anëtare zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, si dhe përshtatjen e sistemeve ekzistuese të kontrollit të brendshëm financiar me praktikatat më të mira të BE-së në këtë fushë. Lista e përditësuar e akteve ligjore/nënligjore që rregullojnë Kapitullin 32, paraqitet në **Aneksin 2**.

**Kontrolli i Brendshëm** - Për të rritur besimin dhe për të garantuar që fondet publike administrohen me kujdesin e duhur, nevojitet zbatimi i një **sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm financiar**<sup>15</sup>, si një mekanizëm për të monitoruar aktivitetin e kryer nga njësitë e pushtetit qendror dhe ato vendor, të cilët përdorin fonde publike. Sipas legjislacionit shqiptar, termi "**kontroll i brendshëm**" nënkupton *ndërveprimin midis sistemit të menaxhimit financiar dhe auditimit të brendshëm, për të ndihmuar institucionet publike në kryerjen e veprimtarive ekonomike me efektivitet dhe efikasitet*<sup>16</sup>.

Termi "**Auditim i Brendshëm**" është relativisht i ri në Shqipëri. Rregullimi ligjor i funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik u arrit në 2003, me miratimin e Ligjit "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*"<sup>17</sup>. Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit pranë MFE-së u ristrukturua në 2010 si Njësia Qendrore e Harmonizimit dhe Auditimit të

<sup>14</sup> Progres Raporti i Shqipërisë 2021, 19/10/2021 [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)

<sup>15</sup> Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, neni 157, [https://www.gjk.gov.al/web/kushtetuta\\_e\\_integruar\\_me\\_ndryshimet\\_e\\_2016\\_1648.pdf](https://www.gjk.gov.al/web/kushtetuta_e_integruar_me_ndryshimet_e_2016_1648.pdf)

<sup>16</sup> Ligji për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" nr 10 296, date 08.07.2010, i ndryshuar, [https://www.gjk.gov.al/web/kushtetuta\\_e\\_integruar\\_me\\_ndryshimet\\_e\\_2016\\_1648.pdf](https://www.gjk.gov.al/web/kushtetuta_e_integruar_me_ndryshimet_e_2016_1648.pdf)

<sup>17</sup> Ligji nr 9009 date 13.02.2003 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", <https://www.shish.gov.al/files/transparenca/pdf/Ligj%209720.pdf>



Brendshëm (NjQHAB). Po në këtë vit u bë ndarja e funksionit të “**auditimit të brendshëm**” nga “**inspektimi financiar**”, në përputhje me rekomandimet e BE-së. Me miratimin e ligjit “**Për Inspektimin Financiar Publik**”<sup>18</sup> u krijua Drejtoria e Inspektimit Publik (DIP) që luan rol rregullator dhe koordinues me qëllim kontrollin e transaksioneve të kryera nga njësitë dhe individët në sektorin publik, përcaktimin e shkeljeve të ligjeve dhe mashtrimeve të kryera, zbulimin e dëmeve të shkaktuara mbi pasurinë, e njësisve të sektorit publik, si dhe identifikimin e përgjegjësive për kryerjen e parregullsive të individëve.

Ligji i ri “**Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik**”<sup>19</sup>, miratuar në 2015, synon forcimin e parimit të pavarësisë së auditimit, përcakton përgjegjësitë e titullarëve të njësisve publike, drejtuesve të njësisve të auditimit dhe të audituesve të brendshëm, duke njohur detyrimin për hartimin e dokumenteve bazë për funksionimin e auditimit, si **Karta e Auditimit dhe Kodi i Etikës**. Po në 2015, miratohet ligji i ri “**Për Inspektimin Financiar Publik**”<sup>20</sup> që synon organizimin dhe rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale me qëllim efektivitetin dhe besueshmërinë e njësisve publike dhe drejtuesit e tyre.

**Sistemi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP)** - është një koncept i zhvilluar nga KE<sup>21</sup> për të ndihmuar shtetet anëtare në kuptimin dhe vënien në zbatim të sistemeve të kontrollit në mënyrë të krahasueshme në nivel të BE-së. Praktikrat e mira në shtetet anëtare të BE-së njohin dy lloje të sistemit të kontrollit të brendshëm<sup>22</sup>: (i) **sisteme të centralizuara** – ku kontrolli i brendshëm i administratës publike kryhet nga organe të veçanta kontrolli<sup>23</sup>, të pavarura nga autoritetet dhe entitetet që kontrollojnë (Spanja dhe Luksemburgu); dhe (ii) **sisteme të decentralizuara** – ku kontrolli i brendshëm zbatohet si një qasje gjithëpërfshirëse e qeverisë, ku të gjithë menaxherët e njësisve publike, në mënyrë të harmonizuar, krijojnë, mirëmbajnë dhe monitorojnë integritetin e tyre (Danimarka, Holanda, Suedia, etj.).

Shqipëria ka reformuar sistemin e kontrollit të brendshëm në vitin 2003, duke kaluar nga sistem i centralizuar (ku kontrolli i brendshëm kryhej nga KLSH dhe zyrat e kontroll-revizionit) drejt një **sistemi të decentralizuar**, nëpërmjet rregullimit të funksionit të auditimit të brendshëm dhe inspektimit financiar. Ky sistem **vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli**, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen.

<sup>18</sup> Ligji nr 10294/2010 “Për Inspektimin Financiar Publik”, nr. 10 294, date 01.07.2010, [https://www.kqk.gov.al/sites/default/files/publikime/ligji\\_nr\\_10\\_294\\_dt.01.07.2010-per\\_inspektimin\\_financiar.pdf](https://www.kqk.gov.al/sites/default/files/publikime/ligji_nr_10_294_dt.01.07.2010-per_inspektimin_financiar.pdf)

<sup>19</sup> Ligji nr 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, nr. 114, date 22.10.2015, [https://www.kqk.gov.al/sites/default/files/publikime/ligji\\_nr\\_10\\_294\\_dt.01.07.2010-per\\_inspektimin\\_financiar.pdf](https://www.kqk.gov.al/sites/default/files/publikime/ligji_nr_10_294_dt.01.07.2010-per_inspektimin_financiar.pdf)

<sup>20</sup> Ligji nr 112/2015 “Për Inspektimin Financiar Publik”, nr. 112- 2015, [https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/E.1\\_Ligji\\_nr\\_112\\_-\\_2015\\_Per\\_Inspektimin\\_Financiar\\_Publik\\_Blerina\\_ALB.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/E.1_Ligji_nr_112_-_2015_Per_Inspektimin_Financiar_Publik_Blerina_ALB.pdf)

<sup>21</sup> Welcome to the World of PIFC

[https://ec.europa.eu/budget/library/documents/overviews\\_others/brochure\\_pifc\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/budget/library/documents/overviews_others/brochure_pifc_en.pdf)

<sup>22</sup> “Kontrolli i brendshëm” në këtë kontekst kuptohet si i brendshëm për ekzekutivin, në krahasim me kontrollin e jashtëm që ushtrohet nga auditori i jashtëm dhe parlamenti.

<sup>23</sup> Psh. Intervención General de la Administración del Estado i Spanjës ose Inspektimi i Përgjithshëm i Financave i Luksemburgut





Në legjislacionin shqiptar, **KBFP nënkupton** “tërësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm që ushtrohet nga njësitë publike, për të garantuar se menaxhimi financiar dhe kontrolli i njërive publike është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi”<sup>24</sup>. **KBFP vlerësohet si pjesë integrale e menaxhimit të financave publike**, që lidhet me të gjithë buxhetin, në veçanti me të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë qendrore dhe vendore, duke përfshirë fondet e BE-së si dhe fonde të tjera. Kuadri ligjor për KBFP përcaktohet në Ligjin për Buxhetin<sup>25</sup>, ligjin “Për Auditimin e Brendshëm (AB)”<sup>26</sup> dhe ligjin “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK)”<sup>27</sup>, të cilat ofrojnë një kuadër të përshtatshëm ligjor për zbatimin e elementëve bazë të KBFP-së<sup>28</sup>. Kuadri institucional për MFK u është nënshtruar reformave të përsëritura gjatë dekadës së fundit, për të ndryshuar kulturën e menaxhimit financiar me fokus **nga “inputet” tek “rezultatet”**. Përsa i përket vlerësimit të sistemit MFK për vitin 2020<sup>29</sup>, pavarësisht përmirësimit të treguesve dhe ndërgjegjësimit të njërive të qeverisjes së përgjithshme mbi zbatimin e instrumenteve të kontrollit të brendshëm, **problematikë kryesore mbetet angazhimi jo i duhur i titullarëve** të institucioneve në hartimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të KBFP të njësisë.

**Auditimi i Jashtëm** - Kontrolli financiar përfshin edhe rolin e audituesit të jashtëm, të pavarur nga ana institucionale, operacionale dhe financiare, i cili raporton në parlament për përdorimin e burimeve në sektorin publik, në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI). KLSH është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në vend, i cili ushtron kontroll në të gjitha veprimtaritë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridik shtetërorë<sup>30</sup>. Menaxhimi i financave publike dhe aktiviteti i KLSH-së janë të rregulluara në Kushtetutën e Shqipërisë. Baza ligjore që rregullon aktivitetin e KLSH-së është Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”<sup>31</sup>. Zëvendësimi i termit “kontroll” me “auditim” u bë në vitin 2015, me rishikimin e bazës ligjore për përafrimin e mëtejshëm me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), rekomandim i adresuar nga KE për forcimin e pavarësisë institucionale, organizative dhe funksionale të KLSH-së. Në 2015 u përcaktuan edhe kompetencat e KLSH si auditor i jashtëm për financat publike.

<sup>24</sup> Ligji nr. 10,296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN, KONTROLLIN, <https://www.financa.gov.al/ligji-nr-10-296-date-08-07-2010-i-ndryshuar-me-ligjin-nr-1102015-date-15-10-2015-per-menaxhimin-financiar-dhe-kontrollin-i-unifikuar/>

<sup>25</sup> Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, [https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Ligji\\_114\\_22.10.2015.pdf](https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Ligji_114_22.10.2015.pdf)

<sup>26</sup> Ligji nr 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, [https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Ligji\\_114\\_22.10.2015.pdf](https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Ligji_114_22.10.2015.pdf)

<sup>27</sup> Ligji nr. 10,296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN, <https://www.financa.gov.al/ligji-nr-10-296-date-08-07-2010-i-ndryshuar-me-ligjin-nr-1102015-date-15-10-2015-per-menaxhimin-financiar-dhe-kontrollin-i-unifikuar/>

<sup>28</sup> Elementët bazë të KBFP: (i) Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (MFK), (ii) Pavarësia Funksionale e Auditimit të Brendshëm (AB), dhe (iii) Njësia Qendrore e Harmonizimit (NjQH).

<sup>29</sup> Raport mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, 2020 <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Raporti-Vjetor-i-KBFP-2020.pdf>

<sup>30</sup> Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË nenet 162-163, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2007/01/13/9675/7107091e-96b4-4853-b651-a4f2f3814b0b>

<sup>31</sup> Ligji nr 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i rishikuar., [https://www.dap.gov.al/images/LegjislacioniAP/ligj\\_154\\_27.11.2014.pdf](https://www.dap.gov.al/images/LegjislacioniAP/ligj_154_27.11.2014.pdf)

#### 4. Opinionin e KE-së mbi progresin dhe përgatitjet e bëra për Kapitullin 32

KE mbështet dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme përgatitjet e bëra nga Shteti Shqiptar për përmbushjen e kushteve për anëtarësim dhe publikon çdo vit raportin mbi progresin e bërë për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së. Një përmbledhje krahasuese e opinioneve, rekomandimeve dhe prioriteteve kryesore ndër vite, është paraqitur në **Aneksin 3**. Nga viti 2015 deri në Tetor 2021, KE ka mbartur të njëjtin vlerësim: **Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e Kontrollit Financiar**, me një vlerësim mesatar 3, në një shkallë vlerësimi nga 1 në 5. Vlerësimi i plotë për Kapitullin 32, i Raportit të fundit të KE-së për Shqipërinë, është paraqitur në **Aneksin 4**.

**Tabela 1. Progresi ndër vite dhe përgatitja e Shtetit Shqiptar për Kapitullin 32<sup>32</sup>**

Viti	Përgatitja (shkallë 1-5)	Progresi (shkallë 1-5)
2009	Avancim modest	pak progres
2010	Ka filluar përgatitja	NA
2011	NA	Eshte bere progres
2012	(Jo shume avancim)	pak progres
2013	(Avancim modest)	pak progres
2014*	(Avancim modest)	<b>pak progres</b>
2015	3 (Përgatitje modeste)	pak progres
2016	3 (Përgatitje modeste)	pak progres
2018	3 (Përgatitje modeste)	pak progres
2019	3 (Përgatitje modeste)	pak progres
2020	3 (Përgatitje modeste)	pak progres
2021	3 (Përgatitje modeste)	pak progres

\* Statusi i vendit kandidat për Shqipërinë

Njëfarë progresi vlerësohet se është bërë çdo vit, por jo mjaftueshëm për të përmirësuar opinionin e përgjithshëm të përgatitjes së vendit në lidhje me përafrimin e legjislationit për Kapitullin 32. KE vlerëson se funksionimi i duhur dhe efektiv i kornizës së KBFP nuk është siguruar në të gjitha njësitë buxhetore<sup>33</sup>. Rekomandimet e mëparshme të KE-së mbeten ende të vlefshme për tu zbatuar nga Qeveria në vitin 2022, si vijon:

**“Shqipëria duhet:**

- (i) të marrë masa për zbatimin e udhëzimeve për **delegimin financiar të përgjegjësive dhe të miratojë instruksionet për delegimin e përgjegjshmërive menaxheriale me synim përmirësimin e llogaridhënies menaxheriale;**
- (ii) të monitorojë dhe të ndjekë **zbatimin e rekomandimeve të bëra në Raportin vjetor të KBFP nga institucionet buxhetore; dhe**
- (iii) të rrisë **kontrollin parlamentar të organeve të audituara në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm, përmes dëgjimeve më të shpeshta në seanca parlamentare dhe krijimit të një kornize parlamentare monitorimi për të vlerësuar rregullisht aktivitetin e qeverisë në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.”**

<sup>32</sup> Fillimisht vend kandidat potencial 2009-2014, më pas vend kandidat për anëtarësim në BE gjatë 2015-2021

<sup>33</sup> Raporti i Progresit të Shqipërisë, 2021 [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)



## **5. Plani Kombëtar i Integritimit Evropian / Prioritetet dhe planet e veprimit të Qeverisë**

Menjëherë pas nënshkrimit të e MSA-së<sup>34</sup>, institucionet shqiptare janë angazhuar për hartimin dhe miratimin e planeve për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së. Strategjia e parë kombëtare për Integrim<sup>35</sup> përcaktoi objektivin e përafrimit të legjislacionit për periudhën 2007 – 2013, por ende sot ky objektivi nuk është përmbushur. Planet janë përditësuar dhe ndryshuar disa herë në harkun kohor 15-vjeçar. **Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE)**<sup>36</sup>, në formatin aktual, u propozua në vitin 2014 dhe ka si qëllim të koordinojë procesin e përafrimit, duke synuar plotësimin e detyrimeve të MSA-së dhe anëtarësimin në BE. Ky plan afatmesëm rishikohet çdo vit, për një periudhë 3-vjeçare. Qeveria raporton se **PKIE 2021 - 2023 është zbatuar në shkallën 76%**, nivel zbatimi më i ulët se ai i arritur gjatë vitit 2020 në kuadër të zbatimit të PKIE 2020 – 2022<sup>37</sup>.

Plani i përditësuar i Qeverisë “**PKIE 2022-2024**” është miratuar nga Këshilli i Ministrave në Shkurt 2022. Për Kapitullin 32, prioritetet, objektivat dhe planet e përafrimit të legjislacionit paraqiten në **Aneksin 5**.

**Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik** - Masat e KBFP-së janë të përfshira në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2019 – 2022 dhe të detajuara më tej në Dokumentin e Politikave për Zhvillimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik 2021 – 2022, i cili u miratua në Dhjetor 2020. Legjislacioni për kontrollin e brendshëm është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sipas vetvlerësimit të Qeverisë, deklaratat e cilësisë nënshkruhen sistematikisht nga menaxhimi i lartë, por në mungesë të një kornize delegimi, ky mbetet më shumë një ushtrim formal. Qeveria ka miratuar dokumentin e politikave të KBFP-së dhe planin e veprimit përkatës për periudhën 2021-2023, objektivat e të cilit janë paraqitur në **Aneksin 6**. Raporti vjetor i monitorimit të KBFP-së përgatitet nga NjQH pranë MFE dhe paraqitet pranë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit. Përtej raportimit, **nuk ka një vendimmarrje formale nga ana e institucioneve mbi monitorimin dhe zbatimin e rekomandimeve të adresuara nga MFE, për zbatimin e KBFP-së.**

**Auditimi i Jashtëm** - Në zbatim të rekomandimeve të KE-së, KLSH është angazhuar që t'i ridërgojë Kuvendit propozimet: (i) për **ngritjen e një nen-komisioni parlamentar, pjesë e Komisionit për Ekonominë dhe Financat** për shqyrtimin e raporteve të KLSH-së, si dhe zhvillimin në mënyrë periodike të dëgjësive parlamentare për vlerësimin e veprimeve korrigjuese të ndërmarra nga institucionet e audituara për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së; (ii) për **nënshkrimin e një memorandumi mirëkuptimi midis dy institucioneve**, si dhe hartimin e një plani konkret pune për rritjen e kontrollit parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së; dhe (iii) për **amendimin e ligjit për KLSH**<sup>38</sup>,

<sup>34</sup> “Plani Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit” dhe “Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007-2012”

<sup>35</sup> Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, [https://www.connectwith.eu.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-komb%20c3%abtare-p%20c3%abr-zhvillim-dhe-integrim-2008\\_-p%20c3%abr-periudh%20c3%abn-2007-2013.pdf](https://www.connectwith.eu.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-komb%20c3%abtare-p%20c3%abr-zhvillim-dhe-integrim-2008_-p%20c3%abr-periudh%20c3%abn-2007-2013.pdf)

<sup>36</sup> PKIE u hartua për herë të parë për periudhën 2014-2020, dokument që përditësohet çdo vit, për një periudhë 3-vjeçare.

<sup>37</sup> PKIE 2022 – 2024, fq.14, [http://integrimi-ne-be.punetjashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%20c3%8BTAR-P%20c3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN\\_Final.pdf](http://integrimi-ne-be.punetjashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%20c3%8BTAR-P%20c3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf)

<sup>38</sup> Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, [https://www.dap.gov.al/images/LegjislacioniAP/ligj\\_154\\_27.11.2014.pdf](https://www.dap.gov.al/images/LegjislacioniAP/ligj_154_27.11.2014.pdf)

për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit institucional pas mbarimit të mandatit kushtetues të Kryetarit të KLSH. Propozimet vlerësohet se kanë mbetur pezull për një periudhë 2-vjeçare.

**Mbrojtja e interesave financiare të BE-së** - Shqipëria duhet të përafrojë plotësisht Direktivën e BE-së 2017/1371 të datës 5 Korrik 2017 “Për luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiare të Unionit me anë të ligjit penal”, në drejtim të dispozitave penale. Miratimi i **Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit**, e cila synon mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, është përfshirë në **Strategjinë e Mbikëqyrjes së Financave Publike 2019-2022**. Sipas Urdhërit të MFE, Strategjia duhej të miratohej brenda vitit 2022, por për shkak të pandemisë është shtyrë për vitin 2024. Përafrimi i direktives është parashikuar në aktet e Ministrisë së Drejtësisë për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. MFE / strukturat respective përgjegjëse të saj, ku bën pjesë edhe DIFP/AFCOS, do të kenë rol mbështetës në përafrimin e kësaj direktive, në përputhje me fushën e përgjegjësisë të cdo strukture.

**Mbrojtja e euros nga falsifikimi** - Shqipëria është e përafuar me *acquis* të BE-së në mbrojtjen e kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga falsifikimi, duke përfshirë procedurat për grumbullimin, ruajtjen dhe tërheqjen e tyre nga qarkullimi. Një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet KE dhe Bankës së Shqipërisë për monedhat është në fuqi, ndërsa është në pritje një marrëveshje për kartëmonedhat me Bankën Qendrore Evropiane.

## **6. Institucionet e angazhuara në procesin e Integritimit Evropian**

**Kuvendi** – ka rol shumë të rëndësishëm në procesin e përafrimit të legjislationit shqiptar me atë të BE-së, duke ushtruar kontrollin ligjor dhe politik të këtij procesi. Procesi i përafrimit të legjislationit shqiptar me *acquis* të BE-së bazohet në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligjin “*Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Shqipërisë në BE*”<sup>39</sup>. Në përputhje me këtë Ligj, është ngritur dhe funksionon Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (KKIE), si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për IE, që ka objektiv të nxis dhe të garantojë bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe të sigurojë rritjen e transparencës në vendimmarrje për çështjet e integritetit<sup>40</sup>.

**Qeveria** - ka rishikuar disa herë strukturat përgjegjëse për IE, nisur nga fakti se negociatat e anëtarësimit janë procese teknike të komplikuar, që do të kërkojnë koordinim dhe përdorim sa më eficient të burimeve institucionale të administratës publike. Rishikimi i fundit është bërë në 2018, me VKM Nr. 749, datë 19.12.2018 “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Shqipërisë në BE*”. Së fundmi, me VKM Nr. 422, datë 6.5.2020 është përcaktuar **grupi i ri negociator sipas kapitujve**.

**MEF** – ka rol kyç dhe mban përgjegjësinë kryesore për zhvillimin e negociatave dhe zbatimin e detyrimeve për Kapitullit 32, rol që përmbushet nëpërmjet Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit dhe Financiar Kontrollit (NJQH/MFK), Njësisë Qendrore të

<sup>39</sup> Ligji nr. 15/2015, datë 5.3.2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në BE”, [https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji\\_15-2015-1.pdf](https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji_15-2015-1.pdf)

<sup>40</sup> Institucionet kryesore të angazhuara në procesin e Integritimit Evropian janë paraqitur në Aneksin 7.

Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (NJQH/AB) dhe Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik. Përgjegjësia e mbikëqyrjes së zbatimit të reformave i takon MEF, ndërsa **strategjia e MFP dhe Kontrollit përfshin Qeverinë, KLSH dhe Kuvendin**, roli i të cilëve duhet të jetë më aktiv dhe mbështetës ndaj MFE për zbatimin e sistemit të KBFP. Institucionet kryesore të angazhuara në përmbushjen e detyrimeve për kapitullin 32 janë paraqitur në **Aneksin 7**.

## 7. Pasqyrë krahasuese me vendet e rajonit dhe me praktikat e mira të BE-së

Në progres raportet më të fundit (Tetor 2021), KE ka vlerësuar me të njëjtin nivel përgatitjeje Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut (përgatitje modeste), por kjo e fundit me një progres më të limituar gjatë vitit. Të njëjtin nivel përgatitjeje për Kapitullin 32 kanë marrë edhe Mali i Zi dhe Serbia (përgatitje modeste), pavarësisht se dy vendet kanë disa vite që kanë hapur negociatat për anëtarësim. Tabela krahasuese në vijim, sigurisht që nuk prezanton problematikat e secilit vend kandidat, por tregon se **procesi i negociimit mund të jetë i gjatë dhe sfidues, prandaj nevojitet një përgatitje dhe organizim më i mirë i institucioneve të përfshira në negociata**, për të shtyrë procesin përpara me sukses, deri në përmbylljen e negociatave dhe anëtarësimin në BE. Një përgatitje më të mirë ka Turqia, ndërsa Kosova dhe Bosnje Herzegovina kanë një vlerësim më të ulët përgatitjeje. Një përmbledhje e opinioneve dhe rekomandimeve të KE-së për Kapitullin 32, për vendet rajonit, kandidatet ose potencialisht kandidatet për anëtarësim në BE, është paraqitur në **Aneksin 8**.

**Tabela 2. Krahasimi me Rajonin / Progresi i bërë për Kapitullin 32**<sup>41</sup>

Shteti	Statusi i negociatave me KE	Viti i hapjes së negociatave	Përgatitja (shkalle 1-5)	Progresi
Shqipëri	Hapja e negociatave pezull	Na	3 (përgatitje modeste)	pak progres
Maqed. Veriut	Hapja e negociatave pezull	Na	3 (përgatitje modeste)	progres i limituar
Turqi	Janë hapur negociatat me KE	2005	4 (nivel i mire përgatitje)	progres i limituar
Mali i Zi	Janë hapur negociatat me KE	2012	3 (përgatitje modeste)	pak progres
Serbi	Janë hapur negociatat me KE	2014	3 (përgatitje modeste)	progres i mire
Kosove	Kandidat potencial për BE	Na	2 (nivel i ulët përgatitje)	pak progres
Bosnie Herzeg	Kandidat potencial për BE	Na	1 (faze fillestare përgatitje)	pak progres

<sup>41</sup> Rezultatet në tabelë bazohen në vlerësimin e KE-së për gatishmërinë e një vendi për të miratuar detyrimet e anëtarësimin në BE, sipas përshkrimit: 1. Faza fillestare, 2. Nivel i ulët përgatitjeje, 3. Përgatitje modeste, 4. Nivel i mirë përgatitjeje dhe 5. I avancuar.

## **8. Problematikat dhe sfidat në lidhje me Kapitullin 32**

**Kontrolli parlamentar** - Kuvendi ka detyrim ligjor të shqyrtojë në seancë plenare vetëm dy raporte kryesore<sup>42</sup> të KLSH-së. Nga viti 2018 raportohet se Kuvendi nuk ka pasur seanca dëgjimore për raportet e tjera audituese të KLSH-së, si një praktikë e mirë për të monitoruar reformat në sistemin e KBFP. **Mungesa e konkluzioneve dhe rekomandimeve të pavarura nga Kuvendi, në mbështetje të aktivitetit dhe rekomandimeve të KLSH, vlerësohet se dobëson rolin e audituesit të jashtëm të financave publike**<sup>43</sup>. Për të adresuar këtë problematikë, në listën e institucioneve përgjegjëse për Kapitullin 32 duhet të angazhohet edhe Kuvendi, si institucion përgjegjës dhe hallka më e lartë e kontrollit financiar, respektivisht për kontrollin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm të financave publike.

**Cilësia e punës së KLSH** - Në përmbushje të mandatit kushtetues si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, KLSH po punon për amendimin e Ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të rekomandimit të Raportit Vjetor të Komisionit Evropian për sigurimin e vazhdimësisë së veprimtarisë së institucionit edhe pas mbarimit të mandatit të Kryetarit të KLSH-së si dhe për të plotësuar mangësitë e kuadrit ligjor që lidhen mesaktësimin në ligj të kompetencës së auditimit: (a) të fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Evropian, (b) të subjekteve publike/private, të angazhuara, pjesëmarrëse dhe palë në fushat dhe kontratat koncesionare, prokurimit publik dhe partneritetit publik – privat; dhe (c) të personave juridikë publikë, ku përfshihen edhe entet rregullatorë si p.sh Enti rregullator i Energjisë dhe të Bankës Qendrore të Shqipërisë.

**Përgjegjshmëria menaxheriale** – nuk është ende plotësisht e sanksionuar në legjislacion dhe në praktikën administrative. Udhëzimet e miratuara për delegimin e përgjegjësiave financiare duhet të zbatohen dhe të shoqërohen me një reformë më të gjerë për delegimin e përgjegjësiave operacionale dhe administrative, në mënyrë që të kemi një qasje gjithëpërfshirëse për llogaridhënien menaxheriale. Një numër shumë i vogël vendimesh administrative delegohen në praktikë. Rishfaqja dhe rritja e detyrimeve të prapambetura është një tregues për atribuimin ende jo plotësisht efektiv të përgjegjësiave dhe kontrollit të angazhimeve.<sup>44</sup> Njësitë në varësi dhe njësitë e qeverisjes vendore mbeten institucionet më të dobëta për sa i përket funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. MEF dorëzon çdo vit pranë Qeverisë raportin e monitorimit të sistemit të KBFP, në të njëjtën kohë me pasqyrën vjetore të buxhetit. Të dy dokumentet paraqiten edhe në Kuvend. Raportimi nga ana e NjQH/MFE siguron që Qeveria dhe Kuvendi të informohen dhe të jenë të vetëdijshëm për statusin e sistemit KBFP. Raporti i monitorimit përfshin gjetje dhe rekomandime për përmirësim të sistemit kontrollit, por nga ana e Qeverisë nuk ka një vendimmarrje formale për pranimin e rrezikut dhe adresimin rekomandimeve për zbatim nga institucionet publike. Sistemi i kontrollit të brendshëm jep siguri të arsyeshme, por jo absolute, në lidhje me kontrollin financiar dhe mirë-administrimin e fondeve publike, në funksion të përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve. **Krijimi i një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm nuk e zëvendëson, por e përforcon përgjegjshmërinë menaxheriale, si një detyrim i**

<sup>42</sup> “Raporti i Zbatimit të Buxhetit të Shtetit” dhe “Raporti Vjetor i Performancës së KLSH-së”.

<sup>43</sup> Raport Monitorimi për Shqipërinë “Menaxhimi i Financave Publike” – Nëntor 2021 © OECD

<http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf>

<sup>44</sup> PKIE 2022-2024, Kapitulli 32, fq 495, [http://integrimi-ne-be.punetesjashme.gov.al/wp-](http://integrimi-ne-be.punetesjashme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%20BTAR-P%20BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf)

[content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%20BTAR-P%20BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN\\_Final.pdf](http://integrimi-ne-be.punetesjashme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%20BTAR-P%20BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf)



**drejtpërdrejtë i drejtuesve të institucioneve publike për të respektuar parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë dhe të transparencës ndaj publikut.** Për të adresuar këtë problematikë nevojitet rritja e përgjegjshmërisë menaxheriale në adresimin e problematikave dhe forcimin e sistemit KBFP.

**Harmonizimi i menaxhimit dhe kontrollit financiar me reformën e administratës publike** - Reforma për përmirësimin e menaxhimit të financave publike vendos theksin tek përgjegjshmëria menaxheriale brenda kuadrit të një buxhetimi të bazuar në performancë<sup>45</sup>. Kontrolli financiar<sup>46</sup> dhe auditimi i jashtëm<sup>47</sup> përbëjnë dy nga gjashtë objektivat e strategjisë së MFP 2019-2022<sup>48</sup>, rishikuar në vitin 2020 për të mundur monitorimin bazuar në rezultate të matshme. Gjithashtu, Strategjia mbi Reformën e Administratës Publike (SNRAP 2015-2020) synon “zhvillimin e një administrate publike që siguron shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive, dhe efikase ... nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave efikente.”<sup>49</sup> Strukturat e Qeverisë i janë nënshtruar ndryshimeve të mëdha pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017<sup>50</sup>, drejt një sistemi planifikimi të integruar dhe zhvillimi ndërsektorial. **Pavarësisht reformave për rishikimin e kuadrit ligjor për administratën publike, Shqipëria ende nuk ka një arkitekturë të qartë të strukturave buxhetore.** Në disa raste, nuk është e qartë nëse agjencitë duhet të përqendrohen vetëm në zbatimin e politikave, apo kanë rol në hartimin e tyre. Ministrat janë drejtpërdrejt përgjegjës para legjislativit për fushat përkatëse të politikave, ndërsa drejtuesit e agjencive përgjithësisht nuk janë të ekspozuar ndaj mekanizmave të llogaridhënies. Sipas raportit të monitorimit<sup>51</sup>, **reformat në ristrukturimin e agjencive kanë zbuluar dobësi dhe rreziqe sistematike.** Një analizë e detajuar dhe e përditësuar e koherencës së legjislacionit të kontrollit të brendshëm me legjislacionin horizontal mund të identifikojë probleme që duhet të adresohen për përmirësimin e kontrollit financiar.

**Vlerësimi i objektivave mbi rezultate të matshme** - Sipas Raportit të KE për Shqipërinë<sup>52</sup> “analiza e punës së qeverisë është ende e kufizuar, sepse monitorimi dhe raportimi shpesh kufizohen në zbatimin e aktiviteteve dhe rrallë vlerësojnë rezultatet e tyre. Shumica e raporteve vazhdojnë të prezantojnë aktivitetet e zbatuara dhe nuk shpjegojnë rezultatet dhe

<sup>45</sup> Ligji për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, [http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%20BTAR-P%20BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN\\_Final.pdf](http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%20BTAR-P%20BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf)

<sup>46</sup> Objektivi Specifik 5: Kontrolli i brendshëm efektiv - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (MFK) në Institucionet Publike

<sup>47</sup> Objektivi Specifik 6: Mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike - Auditimi i Jashtëm

<sup>48</sup> Ministria e Financës dhe Ekonomisë, STRATEGJIA SEKTORIALE E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE 2019-2022, <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/PFM-Strategy-2019-2022-ALB-1.pdf>

<sup>49</sup> STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2015 – 2022 <https://www.adisa.gov.al/ep-content/uploads/2021/03/Strategjia-Ndersektoriale-SNRAP-2015-2022.pdf>

<sup>50</sup> Raport i Vlerësimit të Performancës lidhur me llogaridhënien për shpenzimet dhe financat publike (PEFA) – Shqipëria, (PEFA) – Shqipëria, 2017 [https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Llogaridhenia\\_per\\_Shpensimet\\_dhe\\_Financat\\_Publike\\_PEFA\\_2017\\_.pdf](https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Llogaridhenia_per_Shpensimet_dhe_Financat_Publike_PEFA_2017_.pdf)

<sup>51</sup> OECD, SIGMA PAPER NR.63, ORGANISATION OF PUBLIC ADMINISTRATION: AGENCY GOVERNANCE, AUTONOMY AND ACCOUNTABILITY, OCTOBER 2021, <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/07316cc3-en.pdf?expires=1654784987&id=id&accname=guest&checksum=DF7B05BB0743C40F0C62FD2D2F1687E6>

<sup>52</sup> Raporti i Progresit të Shqipërisë, 2021 [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)

*përfundimet aktuale që janë arritur përmes zbatimit të politikave qeveritare.” Ky konstatim qëndron edhe për Kapitullin 32, për faktin se theksi vihet më shumë tek aktiviteti i kryer (reformat apo përafrimi i legjislacionit), sesa tek objektivat e arritura për zbatimin e sistemeve të kontroleve në menaxhimin e financave publike. Sipas Raportit të Monitorimit PAR<sup>53</sup>, **zbatimi i kontrollit të brendshëm në nivel institucional mbetet i mangët, kundrejt progresit të bërë me kornizën e përgjithshme ligjore.** Vlerësimi i treguesit 'funksionimi i kontrollit të brendshëm' për vitin 2020 është shumë i ulët (“1” në një shkallë nga 1 në 5), me përkeqësim nga viti 2017, për arsye se cilësia e planifikimit dhe organizimit të auditimeve nuk është provuar gjatë testimit në terren nga SIGMA. Sado progres të quhet përafrimi ligjor, kontrolli financiar nuk mund të jetë i plotë dhe as efektiv, nëse themelet e tij vijojnë të jenë të brishta, në mungesë transparence dhe përgjegjshmërie menaxheriale. **Zbatimi i sistemit të kontrollit përbën kriter vlerësues për fazën negociuese, ndaj fokusi duhet të jetë tek rezultatet e reformave, përtej përafrimit të legjislacionit.***

**Roli i shoqërisë civile në përmirësimin e llogaridhënies** - Një arsye e rëndësishme për t'i kushtuar vëmendje Kapitullit 32 është fakti se politikat dhe procedurat e kontrollit financiar synojnë vlerësimin e situatës dhe rritjen e transparencës mbi mënyrën sesi administrata publike i shpenzon paratë e taksapaguesve. Auditimet e performancës synojnë të vlerësojnë nëse paratë e shpenzuara janë përdorur në mënyrë efektive dhe kanë dhënë rezultatet e pritura. Përgjegjshmëria dhe llogaridhënia menaxheriale e institucioneve publike shtrihet në disa nivele, duke filluar nga kontrolli i brendshëm, kontrollorët e jashtëm që kanë kompetenca për të vendosur edhe sanksione (KLSH dhe kontrolli parlamentar), dhe së fundmi publiku i gjërë. **Roli i shoqërisë civile në forcimin e mekanizmit të kontrollit financiar publik është thelbësor, pasi mund dhe duhet të kryejë monitorim të vazhdueshëm të proceseve që kanë ndikim në jetën ekonomike, sociale dhe politike.**

## 8. Përfundime dhe Rekomandime

Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor dhe operacional për kontrollin financiar por zbatimi ka mangësi të theksuara. KLSH ka përditësuar metodologjitë e auditimit dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, por mbetet ende punë për të bërë për të përmirësuar cilësinë dhe ndikimin e auditimit të jashtëm. Çështjet prioritare të adresuara nga KE, të mbartura ndër vite në Raportet e KE-së, konvergojnë në kërkesën emergjente të **forcimit të kontrollit parlamentar**, për monitorimin e zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe rekomandimeve të auditimit të jashtëm.

KLSH ka paraqitur propozime për krijimin e një nënkomisioni parlamentar dhe një projekt-memorandum për forcimin e komunikimit midis dy institucioneve, të cilat ende nuk kanë marrë zgjidhje nga Kuvendi. Vendosja e tonit të duhur në krye është element kryesor i mjedisit të kontrollit, që reflektohet në ushtrimin e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë sistemin e KBFP. Mungesa e angazhimit të qëndrueshëm dhe të strukturuar nga ana e Kuvendit vlerësohet si një dobësim i sistemeve të kontrollit dhe përkeqësim i imazhit të punës së kryer nga KLSH. Si rezultat i **mungesës së angazhimit të kontrollit parlamentar**,

<sup>53</sup> Raport Monitorimi The Principles of Public Administration ALBANIA November 2021  
<http://www.sigmaxweb.org/publications/Monitoring-Report-Executive-Summary-2021-Albania.pdf>



efektiviteti i punës së kontrollit cenohet dhe rekomandimet e kontrollit nuk gjejnë zbatim në kohë nga subjektet e audituara.<sup>54</sup>

### Rekomandohet që Kuvendi:

- (i) të adresojë sa më shpejt propozimet e KLSH-së, për amendimin e kuadrit ligjor në përputhje me rekomandimet e BE dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të jashtëm, për të qartësuar rolin dhe fushën e veprimit të KLSH-së, si auditues i jashtëm i financave publike.
- (ii) të trajtojë me prioritet propozimin për krijimin e një nënkomisioni të ri, ose të zgjerojë fushën e përgjegjësisë së “Nën-komisionit për monitorimin e zbatimit të buxhetit të shtetit dhe kontrollin e tij”<sup>55</sup>, për të përfshirë çështjet e auditimit të jashtëm.

Përgatitja për kapitullin 32 duhet të jenë prioritet, për të përshpejtuar hapjen e negociatave për kapitujt e tjerë, si dhe përmbylljen me sukses të negociatave drejt Integritit. Progresi i bërë për këtë Kapitull duhet të vlerësohet si një **reformë gjithëpërfshirëse e KBFP**, në harmoni dhe mbështetje reciproke me reformat PAR dhe MFP. Krijimi i agjencive të reja,<sup>56</sup> pikërisht në fazën kur Shqipëria pret hapjen e negociatave me BE-në, shton paqartësitë dhe kompleksitetin e strukturës organizative në administratë publike. Mungesa e qartësisë mbi rolin e tyre, vështirëson ndarjen transparente të përgjegjësisë brenda Qeverisë, gjithashtu përbën një sfidë për transparencën dhe llogaridhënien menaxheriale.

### Rekomandohet që Qeveria:

- (iii) të përshpejtojë procesin e shqyrtimit analitik (screening) të legjislacionit për përafrimin me acquis të BE-së për Kapitullin 32, si pjesë e klasterit të të drejtave themeltare (fundamentals),
- (iv) paralel me shqyrtimin vertikal, të kryhet një vlerësim horizontal ndërsektorial i legjislacionit për të shmangur mangësitë dhe mbivendosjet që mund të cenojnë efektivitetin e sistemit të KBFP, përfshirë rolin e agjencive të reja të krijuara rishtazi, me qëllim inventarizimin e plotë të politikave dhe akteve ligjore të Kapitullit 32.

Procesi i negocimit për Kapitullin 32 është shumë teknik, kompleks, gjithëpërfshirës. Nisur edhe nga eksperiencia e vendeve të tjera në rajon, nevojitet angazhim maksimal nga të gjitha palët, përfundimi i analizës shqyrtuese të legjislacionit, ekspertizë dhe qëndrueshmëri e strukturave dhe burimeve njerëzore të përfshirë në procesin e negocimit, bashkëpunim ndër institucional dhe mbështetje prioritare nga Qeveria dhe Kuvendi. MFE, institucioni lider në hapjen dhe zhvillimin e negociatave për Kapitullin 32, ka një hapësirë të dedikuar në faqen e saj të internetit<sup>57</sup>, por mungon plotësisht informacioni dhe përditësimet mbi statusin e

<sup>54</sup> Programi SIGMA, Raport Monitorimi The Principles of Public Administration ALBANIA November 2021, <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-Executive-Summary-2021-Albania.pdf>

<sup>55</sup> Nënkomisioni për monitorimin e zbatimit të buxhetit të shtetit dhe kontrollin e tij, <https://www.parlament.al/Strukture?kategori=6&strukture=2060>

<sup>56</sup> Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Shëndetësor, Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje. Agjencia për Kadastrat, etj.

<sup>57</sup> Platforma e Partneritetit të Integritit European, <https://www.financa.gov.al/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-europian/>



përbushjes së detyrimeve për Kapitullin 32. Mungesa e transparencës dhe komunikimit të vazhdueshëm cënon besimin e publikut në përbylljen me sukses të negociatave dhe procesit të anëtarësimit në BE.

**Rekomandohet që MFE:**

(v) të përmirësojë transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut për përbushjen e detyrimeve të përafritit me acquis të BE-së për Kapitullin 32, si pjesë e klasterit të të drejtave themeltare.



## LISTA E SHKURTIMEVE

AAPAA - Agjencia e Auditimit të Projekteve të Asistencës së Akredituar nga BE  
AB - Auditimi i Brendshëm  
AJ - Auditimin e Jashtëm  
AZHBR - Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural  
BE - Bashkimi Evropian  
BSH - Banka e Shqipërisë  
DIFP/AFCOS - Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik/ Shërbimi i Koordinimit të Antimashtrimit  
DIP - Drejtoria e Inspektimit Publik  
IFP - Inspektimin Financiar Publik  
INSTAT - Instituti i Statistikave  
INTOSAI - Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit  
KB - Kontrolli i Brendshëm  
KE - Komisioni Evropian  
KBFP - Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik  
KIE - Komisioni për Integrimin Evropian  
KKIE - Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian  
KLSH - Kontrolli i Lartë i Shtetit  
KM - Këshilli i Ministrave  
KMBE - Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian  
MB - Ministria e Brendshme  
MB/DPPSH - Ministria e Brendshme /Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit  
MD - Ministria e Drejtësisë  
MEPJ - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme  
MFE - Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
MFK - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli  
MFP - Menaxhimi i Financave Publike  
MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asocimit  
MSHMS - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
NjAB - Njësi e Auditimit të Brendshëm  
NjQH - Njësia Qendrore e Harmonizimit  
NjQP - Njësi të qeverisjes së përgjithshme  
NjQV- Njësi të qeverisjes vendore  
PAR - Reforma e Administratës Publike  
Qeveria - Qeveria Shqiptare  
Raporti - Progres Raporti i KE-së  
SPAK - Strukturë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar



## BIBLIOGRAFIA

1. Komisioni Europian, Progres - Raporti për Shqipërinë 2021, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)
2. Komisioni Europian, (2018), A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, p. 4, [https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf)
3. PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN (PKIE 2021– 2023), VKM Nr. 90, datë 17.2.2021, [http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6170&token=5fde9f7a2fd7e514f53b853364e79ca24f397160PKIE\\_21-23](http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6170&token=5fde9f7a2fd7e514f53b853364e79ca24f397160PKIE_21-23)
4. Ministria e Punëve të Jashtme, Marrëveshjet Shqipëri-BE, <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/dokumente/marreveshjet-shqiperi-be/>
5. Ministria e Punëve të Jashtme, Kapitujt e Acquis Communautaire, <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/negociatat/>
6. Ministria e Punëve të Jashtme, PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2022 – 2024, fq 8, , <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/plani-kombetar-i-integrimit-pkie/>
7. Këshilli i Bashkimit Europian, Përfundimet e KE të 24.06.2014 për Shqipërinë, <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8288-2014-INIT/en/pdf>
8. Ligji për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nr 10 296, date 08.07.2010, i ndryshuar”, <https://www.financa.gov.al/ligji-nr-10-296-date-08-07-2010-i-ndryshuar-me-ligjin-nr-1102015-date-15-10-2015-per-menaxhimin-financiar-dhe-kontrollin-i-unifikuar/>
9. Ligji nr 9009 date 13.02.2003 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, <https://www.shish.gov.al/files/transparenca/pdf/Ligji%209720.pdf>
10. Ligji nr 10294/2010 “Për Inspektimin Financiar Publik”, nr. 10 294, date 01.07.2010, [https://www.kqk.gov.al/sites/default/files/publikime/ligji\\_nr\\_10\\_294\\_dt.01.07.2010-per\\_inspektimin\\_financiar.pdf](https://www.kqk.gov.al/sites/default/files/publikime/ligji_nr_10_294_dt.01.07.2010-per_inspektimin_financiar.pdf)
11. Ligji nr 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, nr. 114, date 22.10.2015, [https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Ligji\\_114\\_22.10.2015.pdf](https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Ligji_114_22.10.2015.pdf)
12. Ligji nr 112/2015 “Për Inspektimin Financiar Publik”, nr. 112- 2015, [https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/E.1\\_Ligji\\_nr\\_112\\_-\\_2015\\_Per\\_Inspektimin\\_Financiar\\_Publik\\_Blerina\\_ALB.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/E.1_Ligji_nr_112_-_2015_Per_Inspektimin_Financiar_Publik_Blerina_ALB.pdf)
13. Komisioni Europian, Welcome to the World of PIFC [https://ec.europa.eu/budget/library/documents/overviews\\_others/brochure\\_pifc\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/budget/library/documents/overviews_others/brochure_pifc_en.pdf)
14. Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, [https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Ligji\\_114\\_22.10.2015.pdf](https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Ligji_114_22.10.2015.pdf)
15. Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Raport mbi Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, 2020 <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Raporti-Vjetor-i-KBFP-2020.pdf>



16. Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË nenet 162-163, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2007/01/13/9675/7107091e-96b4-4853-b651-a4f2f3814b0b>
17. Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i rishikuar, [https://www.dap.gov.al/images/LegjislacioniAP/ligj\\_154\\_27.11.2014.pdf](https://www.dap.gov.al/images/LegjislacioniAP/ligj_154_27.11.2014.pdf)
18. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, <https://www.connectwitheu.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-komb%c3%abtare-p%c3%abr-zhvillim-dhe-integrim-2008-p%c3%abr-periodh%c3%abn-2007-2013.pdf>
19. Ligji nr. 15/2015, datë 5.3.2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në BE”, [https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji\\_15-2015-1.pdf](https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji_15-2015-1.pdf)
20. PLANI KOMBËTAR I INTEGRITIT EUROPIAN 2021-2023, [https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Ligji\\_114\\_22.10.2015.pdf](https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Ligji_114_22.10.2015.pdf)
21. “Raporti i Zbatimit të Buxhetit të Shtetit” dhe “Raporti Vjetor i Performancës së KLSH-së”.
22. Programi SIGMA, Raport Monitorimi për Shqipërinë “Menaxhimi i Financave Publike” – Nëntor 2021 © OECD <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf>
23. STRATEGJIA SEKTORIALE E MENAZHIMIT TW FINANCAVE PUBLIKE 2019-2022, <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/PFM-Strategy-2019-2022-ALB-1.pdf>
24. STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2015 – 2022 <https://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/Strategjia-Ndersektoriale-SNRAP-2015-2022.pdf>
25. Banka Botërore, Raport i Vlerësimit të Performancës lidhur me llogaridhënien për shpenzimet dhe financat publike (PEFA) – Shqipëria, (PEFA) – Shqipëria, 2017 [https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Llogaridhenia\\_per\\_Shpensimet\\_dhe\\_Financat\\_Publike\\_PEF\\_A\\_2017\\_.pdf](https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Llogaridhenia_per_Shpensimet_dhe_Financat_Publike_PEF_A_2017_.pdf)
26. OECD, SIGMA PAPER NR.63, ORGANISATION OF PUBLIC ADMINISTRATION: AGENCY GOVERNANCE, AUTONOMY AND ACCOUNTABILITY, OCTOBER 2021, <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/07316cc3-en.pdf?expires=1654784987&id=id&accname=guest&checksum=DF7B05BB0743C40F0C62FD2D2F1687E6>
27. Raport Monitorimi “The Principles of Public Administration”, ALBANIA November 2021 <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-Executive-Summary-2021-Albania.pdf>
28. Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Platforma e Partneritetit për Integrimin Europian, <https://www.financa.gov.al/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-european/>
29. Ministria e Jashtme, PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2019 – 2021, Kapitulli 32, <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/PKIE-2019-2021.pdf>



30. Parlamenti i Republikës së Shqipërisë, Përafrimi i legjislacionit, <https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrimId=6>
31. Raporti vjetor KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EUROPIAN 2020, <https://www.parlament.al/Files/Integrimi/Raporti%20i%20KKIE%20p%C3%ABr%20vitin%202020.pdf>
32. Parlamenti i Republikës së Shqipërisë, Komisioni për Integrimin Europian, <https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrimId=5>
33. Ministria e Jashtme, PLANET KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2014-2024, <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/plani-kombetar-i-integrimit-pkie/>
34. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Platforma Platforma e Partneritetit të Integrimit Europian, <https://www.financa.gov.al/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-europian/>